

## INSTITUCIONET E ARTIT NË KONTEKSTIN E TRASHËGIMISË KULTURORE

Institucionet dhe vendet publike të kulturës<sup>1</sup>, si kujdestarë dhe përkthyes të trashëgimisë kulturore i përkasin institucioneve që kontribuojnë në formimin e një historie si hapësira të vetme kulturore të identitetit kombëtar<sup>2</sup>. Megjithëse, institucionet dhe vendet publike të kulturës në kohë të ndryshme performuan funksione të ndryshme, ndonjëherë thellësisht konfliktuale, tanimë procesi i evolucionit të tyre është në rrugën e gjetjes së paradigmave të reja kulturore që karakterizohet nga krijimi i një institucioni të ri socio-kulturor.

Përmes krijimit të hapësirave të hapura, vendet kulturore dhe muzeale përmirësohen nga proceset e shpejta transformuese për shoqërinë dhe në shumë aspekte varen jo vetëm nga pajisjet teknike moderne, përmirësimi i formave ekspozitive, forcimi i bazës materiale, por edhe nga zhvillimi profesional i personelit dhe i plan-udhëzuesve të tyre, për të përdorur parime të reja të ndërveprimit në punën me audiencat dhe vizitorët.<sup>3</sup> Prandaj edhe specifika e muzeve të teatrit, mbështetet në përmirësimin e njohurive dhe ngritjen e nivelit profesional, zhvillimin e aftësive praktike dhe kompetencave profesionale të specialistëve të shërbimit në fushën e një prezantimi holistik të historisë së zhvillimit të tyre. Por, për të përmbushur këto nevoja, lind nevoja për veprime të reja legjislative apo forma të veçanta organizative që burojnë nga dija se buxhetet publike nuk mund

---

\* Herida Duro, drejtore e strategjive dhe politikave të zhvillimit kulturor në Ministrinë e Kulturës, Shqipëri. Kandidate për Doktore Shkencash në fushën e Trashëgimisë Kulturore, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Universiteti i Tiranës

1 Në kuptim të ligjit nr. 27/2018, institucionet dhe vendet publike të kulturës, i përkasin subjekteve publike që shfrytëzohen për interes publik dhe janë në shërbim të publikut.

2 Ligji referues në lidhje me muzetë në territorin Shqiptar është ligji nr. 27/2018, «Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë» me objekt: ruajtjen, mbrojtjen, vlerësimin dhe administrimin e trashëgimisë kulturore kombëtare, trashëgimisë kulturore muzeale, peisazhit, si kontribues në ruajtjen e kujtesës kombëtare, materialeve dhe të dukshme si pjesë e përfaqësimit të identitetit kombëtar, si shprehje e vlerave kulturore dhe promovimit të zhvillimit kulturor në vend.

3 T. Portnova: "Theater museums in the system of using excursion programs". *Art Human Open Acc J.* 2019; f. 285-287.

të financojnë mjaftueshëm kërkesat e institucioneve muzeale teatrore, për shkak edhe të situatave të pakthyeshme të cilat janë zhvilluar me shpejtësi gjatë viteve të fundit.

Të klasifikuara (deri më sot), si institucione të arteve performuese (skenike), (qendrore dhe vendore) në Shqipëri funksionojnë mbi 20 të tilla në rang vendi. Institucionet kryesore kulturore janë të përqendruara kryesisht në Tiranë, të ndjekura nga Korça, Shkodra, Elbasani, Durrësi, Fieri, Gjirokastra dhe Vlora, duke bërë që në këto qytete të ketë një jetë relativisht të pasur kulturore dhe gjithëvjetore. Teatrot publike kombëtarë, nëpërmjet politikave drejtuese dhe menaxhuese, zhvillojnë dhe krijojnë produksione të cilësisë bashkëkohore dhe integruese me vendet e rajonit dhe ato të komunitetit europian, dhe që njëkohësisht ndjekin vazhdimisht politika që kontribuojnë për artin skenik si pronë jo vetëm e një elite të caktuar, por gjithnjë e më tepër atraktive, tërheqëse ndaj brezit të ri dhe publikut të gjerë në përgjithësi.

Teatrot financohen nga fondet publike, por edhe nga donacione, bashkëpunime me entitete ndërkombëtare, si dhe nga fondi i pushtetit vendor. Këtu nuk përfshihen operatorët kulturorë jo fitimprurës (OJQ), sektori privat dhe aktorë të tjerë që operojnë në fushën e kulturës. Institucionet qendrore shtetërore të arteve të performuara skenike janë Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor (TKOBAP), Orkestra Simfonike e Radio Televizionit Shqiptar, Akademia e Arteve, sot Universiteti i Arteve<sup>4</sup>. Institucionet kombëtarë të teatrit janë: Qendra Kombëtare Kulturore për Fëmijë dhe Teatri i Kukullave, Teatri Kombëtar (TK) dhe Teatri Eksperimental “Kujtim Spahivogli”.

Përveç këtyre institucioneve qendrore, funksionojnë edhe qendrat kulturore lokale dhe teatrot publikë vendorë që kanë në përbërje trupa teatrale,<sup>5</sup> qendra kulturore për fëmijë, orkestra apo ansamble muzikore të menaxhuara nga shoqata ose individë, të cilët prodhojnë një jetë kulturore të konsiderueshme. Jeta teatrore në qytetet e tjera është më e pakët, megjithëse në disa prej tyre ekzistojnë teatro dhe institucione të

4 Universiteti i Arteve, është institucioni i vetëm arsimor profesional i lartë dhe më i rëndësishmi në Shqipëri për edukimin artistik në fushën e muzikës, arteve vizuale dhe dramaturgjisë. Mbetet një sfidë e rëndësishme që studentët të regjisë skenike, skenografisë, kinemasë, muzikës, koreografisë, multimedias etj., të shkëmbejnë si dhe të njohin teknologjitë për artin dhe format e tij (të cilat zhvillohen çdo ditë). Ky kompleksitet inovativ skenik, përveç një vepre më koherente dhe shumë më shprehëse në skenë do të sillte dhe një gjithëpërfshirje të shumë artistëve për një vepër skenike.

5 Teatri “A. Z. Çajupi”, Korçë, teatri “Aleksandër Moisiu”, Durrës, teatri “Petro Marko” i Vlorës, teatri “Skampa”, Elbasan, teatrot në Shkodër dhe Gjirokastrë.

tjera kulturore, që dikur kishin njëfarë ndikimi në jetën kulturore të këtyre qyteteve. Janë rreth 7 teatro vendorë, që menaxhohen nga Ligji për Decentralizimin e Pushtetit Vendor, por që ka rezultuar se pushteti vendor nuk ka qenë sa duhet aktiv në mbështetjen e veprimtarive teatrore,<sup>6</sup> duke qenë thjesht punëdhënës dhe duke e tjetërsuar funksionin e tyre si “Pallate të kulturës” në monumente kulturore “dekorative”. Një pjesë e mirë e këtyre trupave teatrore janë joefektive dhe numri i shfaqjeve të vëna në skenë është shumë i ulët. Numri i spektatorëve gjithashtu në disa prej qyteteve është tejet i ulët. Bashkëveprimi me teatrot kombëtarë qendrorë si dhe mbështetja e festivaleve të traditës nga institucioni përgjegjës për artin dhe kulturën, ka dhënë një ndihmesë në riaktivizimin e veprimtarisë së teatrove vendorë më të rëndësishëm në vend, duke bërë që qytete të kulturës si Korça, Shkodra apo Durrësi, të jenë pritës të rrjeteve më të rëndësishme performuese në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Sallat teatrore shfrytëzohen relativisht me eficiencë, por kjo nuk ndodh me të njëjtën përparësi në qytetet e tjera dhe aq më pak në zonat rurale. Çështjet e financimit të kulturës teatrore shqiptare nuk janë analizuar asnjëherë me seriozitetin e duhur, në mënyrë që të udhëhiqen nga kriteret të sakta, të konfirmuara dhe të pranuar, jo vetëm nga strukturat politike, por edhe nga vetë komuniteti i njerëzve që prodhojnë dhe konsumojnë kulturën skenike. Mungesa e nismave në krijimin e mekanizmave të ndryshëm, tregon mungesën e një lloji ekuilibri të qëndrueshëm në treg dhe njëkohësisht dëshmon për mungesën e politikave të qarta në këtë fushë, duke krijuar mangësi që reflektohet te cilësia artistike e pakonkurruar dhe te mungesa e alternativave teatrore. Gjithashtu, trajtimi i krijuesve dhe aktorëve nuk është në nivele të kënaqshme.

Në kuptimin administrativ, strukturat politikëbërëse dhe vendimmarrëse pas viteve ‘90, e përkufizuan kulturën në atë mënyrë që ajo të përfshinte vetëm institucionet artistike dhe kulturore të arteve krijuese dhe të performuara, trashëgiminë kulturore dhe bashkëpunimin kulturor ndërkombëtar, duke lënë jashtë kujdesit fusha të tjera shumë të rëndësishme. Disa aktivitete kulturore si muzetë dhe institucionet e artit, u panë të jenë një pjesë e natyrshme e sigurimit publik, ndërsa të tjerat, të tilla si muzika popullore, krijimet artizanale, moda dhe artet bashkëkohore iu lanë forcave të tregut. Mund të themi me bindje se, në fushën e kulturës

6 Edhe pse pika 1, e nenit 32 të kreut VI të ligjit nr. 10 352, “Për artin dhe kulturën”, përcakton se “Teatrot publikë vendorë përfitojnë 30 për qind nga fondet për kulturën që shpërndan pushteti qendror për pushtetin vendor”, ende sot e kësaj ditë nuk ka udhëzime të pacaktuara për decentralizimin e politikës kulturore në Shqipëri.

burimet kryesore ishin, para së gjithash, krijuesit dhe rrjeti i gjerë i institucioneve, të cilët duke filluar nga muzetë, teatrot, kinematografia, muzika, artet pamore, festivalet e konkurset, botimet, mediat, nëpërmjet këmbënguljes së artistëve dhe drejtuesve të politikave kulturore, arritën të mbajnë gjallë aktivitetet e tyre edhe jashtë skemës së tyre publike, duke kaluar në një rrugë që shpeshherë i referonte ndryshimet thelbësore, si mundësi të reja dhe hapje përballë kulturave të tjera rajonale, europiane dhe botërore. Këto ndryshime erdhën, domosdoshmërisht, së bashku me lindjen e një mentaliteti të ri, por edhe të dobishëm për kombin tonë. Ndryshimet referuan hapjen e Shqipërisë dhe të shoqërisë së saj ndaj botës duke shpallur edhe veçoritë ekulturës sonë referuar kulturave të tjera. Megjithatë kujdesi për identitetin kulturor përfshiu në mënyrë të paspecifikuar mbrojtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë kulturore, gjuhës dhe jetës kulturore shqiptare<sup>7</sup>.

Në trajtimin e veprimtarive teatrore (skenike) ka munguar një vizion menaxherial i qartë dhe afatgjatë, ku duket se ka spikatur parapëlqimi për pjesëmarrje në festivale teatrore në vend të mbështetjes së drejtpërdrejtë të prodhimit teatror, megjithëse, marrja në dorë dhe shqyrtimi i situatës së menaxhimit në burime dhe infrastrukturë, shërbime dhe vepra skenike, duhet kuptuar tashmë si një veprim që kërkon t'i zgjidhë një herë e mirë këto probleme. Sigurisht që mendimi ekonomik ka sjellë njohuri të rëndësishme për operacionet e prodhimit, shpërndarjes dhe ndërmjetësimit të të mirave dhe shërbimeve kulturore, por që shpesh, ekonomia kulturore dështon të shpjegojë veçoritë specifike, veçantitë lokale dhe larminë e sektorit kulturor. Një menaxhim modern i këtyre institucioneve do të bëjë të mundur që ato të orientohen më mirë në ekonominë e tregut, bashkëkohësisë estetike dhe artistike të krijimtarisë së tyre.

## Institucionet qendrore të artit skenik teatror

Institucionet shtetërore, me gjithë reformimin që kanë pësuar ndër vite, nuk e kanë vlerësuar si duhet ristrukturimin si një proces në shërbim të menaxhimit, të rritjes së produksionit dhe cilësisë. Këto institucione janë autonome në veprimtarinë e tyre dhe marrëdhëniet mes tyre dhe Ministrisë së Kulturës (MK)<sup>8</sup> janë të rregulluara me ligj dhe të sanksionuara në

7 Po aty.

8 Ministria e Kulturës, është institucioni qendror që zhvillon politikat kryesore në fushën e arteve të performuara në bashkëpunim me aktorët që veprojnë në fushën e kulturës si institucionet e varësisë, shoqatat kulturore dhe artistike në vend, fondacione dhe krijues të fushave të ndryshme.

statutin e secilit institucion. Ato kanë një buxhet vjetor të akorduar nga MK-ja, i cili shërben për realizimin e projekteve artistike dhe për mbulimin e fondit të pagave dhe prodhimit artistik. Ato tashmë gëzojnë pavarësi të plotë për sa i përket planit artistik, megjithëse financiarisht mbështeten në masën më të madhe nga buxheti i shtetit dhe pjesërisht nga donatorët.

Kompetencat territoriale të teatrove kombëtarë si institucione publike qendrore, janë në varësi të Ministrisë së Kulturës. Për sa i përket shpërndarjes gjeografike dhe veprimtarisë territoriale, dendësia e prezencës së spektatorëve ndiqet në masë të lartë në vendet ku ai shërbehet, duke mos plotësuar misionin e tij transmetues në nivel kombëtar territorial<sup>9</sup>. Funksionimi i teatrove (TK dhe TKOBAP) realizohet në përputhje me dispozitat dhe aktet nënligjore të ligjit “Për artin dhe kulturën” i ndryshuar, statutit të institucionit, rregullores së bordit artistik dhe rregullores së brendshme. Kompetenca lëndore e teatrove, ka si objekt kryesor të veprimtarisë nxitjen dhe zhvillimin e artit skenik, që synon ruajtjen e identitetit kulturor kombëtar, shkëmbimet teatrore ndërkombëtare, realizimin e veprave skenike të autorëve shqiptarë dhe të huaj, eksperimentimin e formave të reja të shprehjes skenike. Gjithashtu, kjo kompetencë përfshin edhe mbështetjen për ruajtjen, zhvillimin, si dhe perfeksionimin artistik profesional të vlerave burimore, duke u mbështetur në folklorin tonë popullor të pasur e të larmishëm dhe në përpunimin e tij.

Prodhimi dhe promovimi i kulturës teatrore në Shqipëri, synon transmetimin e vlerave më të mira të teatrit shqiptar, si brenda dhe jashtë kufijve, me përparësi për audiencën shqiptare, duke synuar veçanërisht në nxitjen e krijimtarisë kombëtare. Institucionet teatrore, kanë një kalendar të përcaktuar të aprovuar nga këshillat artistikë (bordet artistike) dhe janë ndjekur nga një numër i kënaqshëm spektatorësh, ku mund të veçohet prania e të rinjve në mes të publikut. Një pjesë e madhe e aktiviteteve të zhvilluara në këto institucione përfaqësojnë një nivel të lartë artistik të krahasueshëm me vende me kulturë muzikore dhe teatrale të zhvilluar. Në publik ka pasur prezencë të njerëzve të profesioneve dhe shtresave të ndryshme të shoqërisë, ku bie në sy, numri i lartë i rinjve të pranishëm në shfaqje (nën 30 -35 vjeç), në veçanti për gala, balete dhe opera.

Kapitali njerëzor, përfshin profesionistët e angazhuar në krijimin aktual të një teatri. Artistët përbëjnë një kategori «të ngrohtë», për të cilën rekrutimi jo vetëm që duhet t'i përgjigjet faturës së teatrit, por

9 J.Papagjoni, në artikullin në kuadër të festimeve 65-vjetorit të TK-së (2010), do të shkruante: “..Shfaqje të panumërta, emra të mëdhenj, histori censure dhe ndalimi. Në këtë art duket se rapaskanat kanë pushtuar skenë, e sa i takon misionit, me kohë, është zbehur”.

shumë shpesh nevojës për t'i dhënë programimit një «apel» të caktuar, duke përfshirë interpretues të njohur profesionistë. Prej vitesh ky art dhe këto institucione, vuajnë probleme të rregullimeve ligjore, probleme të infrastrukturës, probleme të profesionalizmit të trupave dhe të financimit të veprimtarisë skenike. Do të doja të ndalesha më gjatë këtu, edhe për një arsye jo më pak shqetësuese, atë të cilësisë së veprës dhe produksionit. Por kjo nuk mund të demonstrohet pa një studim më preciz të politikave në përgjithësi, dhe atyre të kritikës së mirëfilltë artistike, në veçanti. Brenda termave të menaxhimit kulturor<sup>10</sup>, menaxhimi i muzeve teatralë zë një vend të rëndësishëm në kontekstet e së shkuarës dhe aktuales, për shkak të lidhjeve të veçanta që ai ka gjithmonë me ndikimet politike dhe shoqërore për morinë e funksioneve artistike dhe publike.<sup>11</sup>

Institucionet e kulturës financohen dhe administrohen nga shteti. Në këtë drejtim, nuk ka ndryshuar ende mentaliteti për të prezantuar institucionet kulturore si sektor në një mjedis konkurrues, ku ato mund të konkurrojnë për më shumë burime financiare për të rritur performancën e tyre.

## Trashëgimia e arteve skenike të shekullit XX në Shqipëri

Nga të dhënat që kemi, sot trashëgojmë një numër të madh të veprave skenike, të cilat janë realizuar me mjeshtëri nga artistët e parë dhe ata bashkëkohorë. Kjo trashëgimi e pasur krijimesh dhe interpretimesh prek çdo gjini dhe formë krijuese.

Periodha e shekullit XX në trashëgiminë e artit skenik teatror të Shqipërisë, është zhvilluar përkrah emrave të mirënjohur, pjesë të kujtesës historike dhe kombëtare, ku bëjnë pjesë artistë të mirënjohur shqiptarë. Një pjesë e veprave madhore të dramaturgjisë apo muzikës sonë, janë shkruar përsëri me penë ose me laps, dhe vetëm pjesërisht para vitit 1990, një pjesë e vogël e tyre patën mundësinë që të shihnin dritën e botimit.

10 Menaxhimi i arteve pas shfaqjes së tij në vitet 1960, u bë më shumë term kompleks sesa duket në shikim të parë. Nëse vëmendja origjinale shpesh përqendrohej në mbështetjen e organizatave të jashtëzakonshme jofitimprurëse të artit në marrjen e subvencionit publik, tanimë ajo përfshin organizata komerciale plotësuese që operojnë në industrinë krijuese. Qëllimi i organizatave të artit transferohet te korporatat e biznesit.

11 Feilden & Jolilehto, 2010, f. 25. Argumenton se ndikimi politik shpesh lidhet me ngjarje specifike në historinë e burimit të trashëgimisë në raport me rajonin ose shtetin. Këto ngjarje mund të kenë një ndikim të rëndësia e sotme e burimit kur ato përputhen me prioritetet e objektivave politike bashkëkohore.

Pas vitit 1990, interesi për publikime ka qenë i paktë dhe nuk ka pasur asnjë hapësirë për botime, me përjashtim të nismave private, edhe këto për botime kryesisht komerciale.

Institucionet teatrore shqiptare, zotërojnë një arkivë të shfaqjeve të vëna në skenë si dhe disponojnë një numër të konsiderueshëm dosjesh të materialeve dhe objekteve të veprës skenike, ku janë të shënuar titulli i shfaqjes, autori, regjisori dhe viti. Në këto arkiva, dosje të caktuara përmbajnë materiale të rëndësishme për disa nga veprat dhe shfaqjet më dinjitoze të historisë së teatrove shqiptarë. Brenda dosjeve së shfaqjes së këtyre arkivave, të shtypura me makinë shkrimi, ekziston teksti i dramatizuar nga regjisori më përfaqësues, së bashku me platformën regjisoriale. Përveç skicave të kostumeve dhe posterave të secilës shfaqje, gjejmë edhe një numër të konsiderueshëm fotografish të shkrepura gjatë shfaqjeve. Arkivi fotografik ka një rëndësi të madhe për evidentimin e historikut të teatrove shqiptarë në një periudhë ku shfaqjet nuk regjistroheshin.

Përmes tyre mund të ndërtohet një mozaik i mënyrës vizuale të ndërtimit të shfaqjes, mizanskenave, grimet, kostumeve dhe skenografisë të saj, anës regjisoriale dhe çdo elementi kompleks skenik. Ky dokumentim viziv krijon gjithashtu mundësinë për të njohur artistët e mëdhenj, e në paragrafin mbi aktorët në skenë, fotografitë shërbejnë si një udhërrëfyes për ndërtimin dhe konceptimin e karaktereve vizualisht. Fotografitë e gjetura në këto dosje të arkivave të teatrove kombëtare kthehen në një mjet njohës për brezat pasardhës. Gjetja e këtyre materialeve të një rëndësie të madhe për institucionet skenike, në këto arkiva ishte një zbulim, si një përballje mes së shkuarës dhe të sotmes, si një origjinë, pa të cilën nuk do të arrinim të krijojmë një të ardhme. Përmes kërkimeve nëpër arkiva, haset një tjetër fakt i rëndësishëm, kësaj radhe në arkivat e Bibliotekës Kombëtare, në Arkivin Qendror të Filmit Shqiptar, në institucionin e Arkivit Shtetëror, në arkivat e TKOBAP-së apo Arkivin e Teatrit Kombëtar. Fakti është se në këto arkiva ekziston një numër i konsiderueshëm i literaturës, materiale audiovizive, fakte dhe artefakte, që edhe pse më të pakta në volume dosjesh, janë më të pasura me informacione datash dhe të dhënash korrekte se sa ato të vetë teatrove qendrorë kombëtarë, objekt i këtij studimi.

## Rëndësia e koleksioneve muzeale

Janë shkruar dhe botuar vepra e artikuj mbi historinë e teatrit dhe artin teatror shqiptar dhe atë të huaj, monografi dhe artikuj individualë për regjisorët kryesorë, aktorët, dramaturgët, skenografët dhe të tjerë, të cilët

mund të ndihmojnë shumë në zgjedhjen konceptuale dhe përmbajtjen e programeve të itinerareve turistike, duke pasqyruar rëndësinë e muzeut teatror si qendër për popullarizimin e artit kombëtar dhe atij mbarëkombëtar. Gjenerimi dhe ndikimi i muzeve teatrorë në hapësirën kulturore shqiptare mund të kontribuojë në kërkimin e vetë identifikimit në realitetet e reja historike në kontekstin e realizimit të misionit të tyre shoqëror, për hir të ruajtjes për brezat e ardhshëm, për t'i shërbyer komunitetit dhe zhvillimit të tij.

Arti i teatrit në të gjithë individualitetin e tij, ë është e vështirë për t'u rregulluar, ndaj nuk mund të ruhet për histori, përveçse në muze. Shpjegimet e shfaqjeve, kujtimet e figurave të teatrit, trashëgimia e tyre epistolare, në bazë të të cilave është e mundur të paraqiten fakte individuale dhe ngjarjet e jetës teatrore, janë pjesë e rëndësishme e përmbajtjes dhe e dëshmimeve historike. Ndryshe nga muzetë e artit, ku materialet ndahen sipas teknikës së ekzekutimit, këtu nuk ka një ndarje kaq të qartë, pasi performanca është një e vetme dhe e tërë. Mbi të gjitha, është e rëndësishme që shikuesi të imagjinojë mendërisht personazhet me kostume dhe mjedisin skenik, për të hyrë në laboratorin krijues të regjisorit dhe artistit, për të kuptuar fazat e krijimit të imazheve skenike. Parimi i formimit të fondeve i përdorur në muzetë e teatrit, lejon ruajtjen e unitetit që ishte trajtuar fillimisht në material ikonografik ose dekorativ, i cili nga ana tjetër ndihmon dhe lehtëson studimin e artit të teatrit në tërësi.

Rëndësia e koleksioneve muzeale, duke përfshirë ato teatrale, po rritet në kushtet e një ringjalljeje të interesit të historisë dhe prejardhjes së rajonit, të cilat kontribuojnë në personifikimin dhe shpirtërimin<sup>12</sup> e historisë kombëtare.<sup>13</sup> Muzeumet e teatrit, janë krijuar të ruajnë dhe të transmetojnë nga brezi në brez kodin kulturor dhe historik të kombit, artefakte të aftësive dhe arritjeve në fushën e këtij arti. Në këtë kuptim, muzeu i teatrit nuk është vetëm një pasqyrë e historisë, por ai shfaqet si një institucion i formimit kulturor dhe shoqëror<sup>14</sup>. Rrethi i materialit jetësor

12 Parë në: [https://shqiptarja.com/lajm/trashegimia-kulturore-si-hipoteke-e-shpirtit?r=read\\_more](https://shqiptarja.com/lajm/trashegimia-kulturore-si-hipoteke-e-shpirtit?r=read_more)

13 Në kuptim të po këtij ligji ( ligji nr. 27/2018, neni 190) muze është një institucion i përhershëm, jo-fitimprurës, edukativ, në shërbim të shoqërisë dhe zhvillimit të saj, i hapur për publikun, i cili pasuron fondin, studion, komunikon dhe ekspozon trashëgiminë materiale dhe jo materiale të njerëzimit dhe mjedisit të saj me qëllim edukimin, studimin dhe gëzimin e shoqërisë. Si të tillë, muzetë janë institucione që përfaqësojnë diversitet natyror dhe kulturor të njerëzimit, duke luajtur një rol thelbësor në mbrojtjen, ruajtjen dhe transmetimin e trashëgimisë.

14 Feilden & Jolilehto, 2010, f. 25. Argumentojnë se vlera shoqërore e burimit të trashëgimisë lidhet me aktivitetet tradicionale shoqërore dhe përdorimin e përshtatshëm të tyre në kohët e sotme. Kjo përfshin edhe ndërveprimin shoqëror bashkëkohor në komunitet, dhe që luan rolin e saj në vendosjen e identitetit shoqëror dhe kulturor.

(objekteve) është me të vërtetë i pakufizuar, nga i cili specialistë të muzeve për ekspozita të koleksioneve muzeale teatrore dhe programe itinaresh bazuar në udhërrëfyes me ide inovatore mund të tërheqin kuriozitetin e turistëve. Vizitat në teatër mund të jenë interesante dhe të një rëndësie të veçantë, sepse zbulojnë më qartë thelbin e artit teatror, historinë e zhvillimit të tyre, mjeshtritë e tij, proceset e përgatitjes së shfaqjeve dhe aspektet e tjera të saj.

Muzetë teatrale mbledhin dhe ruajnë kulturën materiale teatrore, të përfaqësuar nga një tjetër botë objektive, duke u përballur me perceptimin vizual, pjesërisht dëgjimor, duke siguruar që me fondet e tyre (të shkruara me dorë, ikonografike, fotografi, dekore dhe materiale video) të thellojnë dhe t' u japin jetë ideve të reja për studimin stilistik, teknikat, tiparet e personaliteteve krijuese, parimet e inskenimit dhe kostumet e periudhave të caktuara historike. Fondet e muzeut përmbajnë materiale të pasura dokumentare mbi historinë e teatrore. Dëshmia (materiale dhe jo materiale) e pranisë dhe e veprimtarisë njerëzore, përbëjnë edhe vlerën shkencore, kulturore, të rëndësishme për individin, komunitetin apo shoqërinë si një e tërë.

Institucionet kulturore që kanë të bëjnë me «performancën e drejtpërdrejtë» si teatrot, qendrat e artit dhe interpretimit, institucionet muzeale dhe ekspozuese arkivore, bibliotekat, qendrat e kulturës shkencore dhe teknike, janë subjekte që evoluojnë në kërkim të misionit të tyre kulturor, veçanërisht në lidhje me mekanizmat e tregut që ndikojnë në shumicën e aktiviteteve të tyre.

Referuar kuadrit ligjor për artin dhe kulturën, mbi të cilin është vepruar dhe mosvepruar, nga ajo që del në pah nga ky studim, rezulton se institucionet e artit, si institucione të rëndësishme të memories (kujtesës) kombëtare nuk e referojnë kuadrin ligjor të fushës së trashëgimisë kulturore. Prandaj punimi evidenton emergjencën e ndërhyrjeve, të cilat synojnë mirëmbajtjen, restaurimin dhe mbrojtjen e aseteve kulturore në gjininë e arteve skenike; mbështetjen e institucioneve dhe vendeve kulturore publike sikurse fondacionet lirike, teatrot dhe ente të shfaqjeve live, (drejtpërdrejta); fuqizimin e strukturave dhe të institucioneve publike të spektaklit dhe vlerësimin e trashëgimisë kulturore, si dhe promovim-prezantimin, duke mbështetur investimet e reja në dobi të rritjes dhe të begatisë së komunitetit. Këndvështrimet e analizës së këtij punimi, synojnë të ridimensionojnë dhe mbështesin përkufizimet sipas standardeve teknike, parametrave të vlerësimit dhe klasifikimit të veprave-fond të artit skenik, manualeve dhe të çdoloj mjeti tjetër të përshtatshëm për përmirësimin

e kujdesit dhe menaxhimit të fondeve publike, ku palët mbartëse të këtyre fondeve kanë për detyrë jo vetëm të sigurojnë mbrojtjen e tyre, por të promovojnë bashkëpunimin e ndërsjellë mes institucioneve, në identifikimin e objekteve si dhe ndërlidhjen e tyre me rrjetet ndërkombëtare përkatëse.

Vlera edukative e prezantimit të fondeve muzeale të trashëgimisë, përfshin potencialin e tij për të zhvilluar turizmin kulturor si dhe ndërgjegjësimin mbi kulturën dhe historinë, vlerën e burimit që ai përfaqëson, si një mënyrë për të integruar burimet historike me jetën e ditëve të sotme. Prandaj dhe vizitat në koleksionet e muzeumeve më të famshëm të teatrit, si në teatrin “Grand Opera” (Paris), teatrin “La Scala” në Milano, teatrin “Covent Garden” në Londër, në “Metropolitan Opera” të Nju Jorkut, në muzeun teator “A. Bakhrushin” (Moskë), në Muzeun e Kulturës Teatrore dhe Muzikore (Shën Petërsburg), në teatrin akademik “Bolshoi i Shtetit” në Moskë dhe në teatrin “Mariinsky” në Shën Petërsburg, bazohen në natyrën spektakolare të artit teator me specifikat e tij. Në muze të tillë ka mjaft arkiva të mëdha, ku ruhen materiale dorëshkrime, plane, punë regjisoriale për vënien në skenë të shfaqjeve, të cilat dëshmojnë për procesin përgatitor dhe atë të prezantimit të tyre për një publik të gjerë. Muzeu përkujtimor, si rregull, përfaqëson figurën teatrore në shfaqjet më të larmishme të karakterit të tij, përcjell atmosferën ku kanë jetuar dhe punuar personalitete të famshme. Me kalimin e kohës, ekspozitat e muzeve të tilla bëhen të paçmueshme si prova më e rrallë e talentit të tyre, veçanërisht kur shumë faqe të historisë teatrore harrohen, publiku (teator) do të jetë i lumtur të takohet me fenomenet që këta artistë përfaqësonin për kulturën e tyre dhe atë botërore.<sup>15</sup>

Kjo formë e prezantimit të kulturës teatrore do të ishte tërheqëse për sektorin e turizmit si qendra të komunikimit shoqëror, duke krijuar një lidhje më të fortë midis shfaqjes artistike dhe pasurisë kulturore të tyre dhe njerëzve. Përveç linjës së produksioneve skenike në teatër dhe funksioneve muzeale, organizimi i shfaqjeve dhe historikut të saj në ekspozita retrospektive janë duke u bërë gjithnjë e më të rëndësishme, duke shërbyer si një mjet për promovimin e vendeve të kulturës, për të rritur numrin e vizitorëve, si një mundësi për të thithur sponsorizime dhe eksperimentuar njëkohësisht. Me pak fjalë, muzetë teatrale duhet të forcojnë më tej dimensionin e tyre publik dhe të jenë të hapur për organizimin e ekspozitave të përkohshme dhe të lëvizshme, nga vetë ata,

15 T. Portnova: “Theater museums in the system of using excursion programs”. *Art Human Open Acc J.* 2019; f. 285-287.

për të rritur interesin e operatorëve të huaj kulturorë që i bëjnë vizitat më të larmishme dhe dinamike.

### ***Bibliografia***

1. 2005:Politikat kulturore në Evropë (Përmbledhje faktesh dhe prirjesh themelore)
2. Këshilli i Europës-Fondacioni Soros.
3. Këshilli i Europës: “Akti i balancimit: 21 dilema strategjike në politikat kulturore”, 1999.
4. Cf. Klamer, A.&Petrova L. & Mignosa A. “Financing the arts and culture in the European Union-Study”, 2006.
5. Strategjia Kombëtare për Kulturën (SKK) 2019-2025, miratuar me VKM nr. 903, datë 24.12.2019.
6. Ligji nr.10 352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe kulturën”, i ndryshuar.
7. Ligji nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, 2018.
8. J.M.Tobelem. “Introduction” La gestion des institutions culturelles. *Musées, patrimoine, centres d'art*. A. Colin, 2017.
9. Broja, XII. “Disa mendime rreth dramaturgjisë dhe artit tonë skenik”. Nëntor, 1960.
10. Brook, P. “Human Connection the Development of Theatre”, 2009.
11. Cambridge Scholars Publishing: The Heritage Theatre: Globalisation and Cultural Heritage, 2011.
12. Daka, Gj. “Pjesët nacionale dhe teatrot tona”. Nëntor, 1960.
13. ETC European Theatre Convention. “Designing the New Decade”. (ETC Journal 2020/2021).
14. Halbertsma, M & Stipriaan, A&Ulzen, P. “The Heritage Theatre”: *Globalisation and Cultural Heritage*, 2011.
15. Hoti, G. “Historia e fillimit të teatrit shqiptar”, (Botoi - Bota shqiptare, Tiranë. 2011) ISBN 978-9928-00-050-07.
16. Këlliçi, Z. “Ç’më kujton ky zë”, “*Historiku i TKOB*”, (Botoi “Bota shqiptare”, Tiranë, 2011) ISBN 978-9928-00-050-07.
17. Luarasi. M. “Teatri Kombëtar në udhëkryq”. Tiranë, 2012.
18. Krantia, M. “Opera e parë kombëtare në skenën tonë”. Gazeta “Bashkimi”, 1994.
19. Ligji nr.9631, datë 30.10.2006, “Për artin skenik”.

20. Luarasi, M. “Teatri Kombëtar në udhëkryq”. (1995) S.000237856.
21. M. Pierotti& G. Risaliti& G. Cestari. “Managing IC in an Opera House”: The Case of La Scala’ European Scientific Journal vol.10, 2014.
22. Papagjoni, J. “Teatri Kombëtar” (Tiranë, 2005) ISBN 99943-763-6-5.
23. Pashuk, R. “Rrezja e rrethit”, *Shfaqje therore* (1943).
24. Stalina, F. & Logoreci, P. “Divat e Teatrit Kombëtar”, *Homazh në 70- vjetorin e Teatrit Kombëtar (1945-2015)*. Tiranë, 2016.
25. TK. “Shekspir”, në Teatrin Kombëtar (2012).
26. T.Portnova: Theater museums in the system of using excursion programs. *Art Human Open Acc J*. 2019; f. 285-287.
27. Pano, A. “Njëzet vjet me Teatrin Popullor”. Tiranë, 1977.
28. Hajro, R. “Për të kujtuar një kohë...”, (Botoi shtëpia botuese “Afërdita”. Tiranë, 1998).
29. Gurakuqi, L. “45 vjet TOB”, (Botoi Pen Club Orana, Shkodër: 1999), f. 270, ISBN 99927-632-0-5.

OPINION

**Univers**

